

3688  
07.04.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
VLORË

Nr. i regjistrimit 2258  
Dt. e regjistrimit 06.12.2019

Nr. i vendimit 158  
Dt. e vendimit 27.01.2020

VENDIM

RZ

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

Gjyqtare: Arbana Selmanaj, asistuar nga sekretarja gjyqësore Blerina Brahimi, sot më 27.01.2020, në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, mori në shqyrtim kërkesën penale si më poshtë:

- Kërkues:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga prokuror Arjan Xhaferraj.
- Objekti:** Pushim i procedimit penal nr. 419/2018.
- Baza ligjore:** Nenet 24/2, 328/1 gërma d) dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata pasi dëgjo prokurorin i cili kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe pasi shqyrtoi aktet e paraqitura,

**VËREN:**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur këtë kërkesë për pushimin e procedimit penal të regjistruar mbi bazën e informacionit të ZVRPP Vlorë në lidhje me një dokumentacion i dyshuar si i falsifikuar.

Në datë 05/02/2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është administruar materiali i dërguar nga ana e Zyrës Vendore të Pasurive të Paluajtshme Vlorë. Nga përmbajtja e materialit të mësipërm dhe dokumentacionit bashkangjitur, rezulton se në datë 19/01/2018, nga ana e shtetasit Dejvin Sharra është aplikuar pranë ZVRPP Vlorë, për marrjen e një informacioni zyrtar pranë ZVRPP Vlorë në lidhje me një pasuri të paluajtshme. Praktika përkatëse i është kaluar për veprim inxhinierit të zonës kadastrale me nr.8605, i cili ka plotësuar formularët me numrat e pasurisë dhe më pas plotësimi i tyre është bërë nga ana e juristit që ka trajtuar këtë praktikë.

Nga verifikimi i informacionit dixhital të zonës kadastrale me nr.8605, hartës dhe informacionit të rifreskuar të kësaj zone, ka rezultuar se pasuria me nr.13/8, është e regjistruar në volumin nr.17, faqe 137, e llojit truall, me sipërfaqe prej 3031m<sup>2</sup>, në pronësi "Shtet".

Ndërkohë, fizikisht kartela në volumin me nr.17137, është me numër pasurie 13/8/1, e llojit truall, me sipërfaqe 2590m<sup>2</sup>, në favor të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota. Lidhur me këtë fakt është mbajtur edhe procesverbali i konstatimit i datës 25/01/2018. Regjistrimi i mësipërm rezulton të jetë bërë me referencë nr.05905, e cila ndodhet në arkivën e ZVRPP Vlorë. Në faqen e parë të inventarit të dosjes me 50 numra, ndodhur në arkivë, kjo referencë është bosh. Me urdhërin me nr.014544 Prot datë 25/01/2018, është vendosur kufizim (ndalim) për këtë pasuri. Nisur nga sa më sipër, bazuar në materialet fillestare të administruara, është kryer regjistrimi i procedimit penal për veprën penale të "Falsifikimi i dokumentave" dhe "Shperdorim detyre" parashikuar nga neni 186/1 dhe 248 i Kodit Penal.

Nga hetimet e mëtejshme të kryera në funksion të këtij procedimi penal, është sekuestruar e gjithë praktika e pronësisë së regjistruar në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, me nr.13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605.

Në funksion të hetimeve është vendosur kryerja e ekspertimit teknik-grafik në lidhje me dokumentin "Kartelë e pasurisë së paluajtshme me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota". Sipas aktit të

ekspertimit teknik-grafik me nr.12779 date 12/12/2018, të përpiluar nga ana e Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, ka rezultuar se :

1. Në dokumentin "Kartela e pasurisë së paluajtshme" me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje fallcifikuese.

2. Fallsifikimi konsiston në mbartjen me anën e skanerit dhe të printimit me printer me ngjyra, i plotesimit të rubrikave në dokumentin e sipërcituar.

3. Shenja e vulës me tekst: "Republika e Shqipërisë Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë," në dokumentin "Kartela e Pasurisë së Paluajtshme" me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, objekt ekspertimi dhe shenjat e vulave me të njëjtin tekst modele krahasimi, nuk janë formuar nga e njëjta klishe vule.

4. Në lidhje me llojin dhe cilësinë e letrës së dokumentit "Kartela e Pasurisë së Paluajtshme", me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, objekt ekspertimi, nuk mund të konkludohet.

5. Dokumenti "Kartela e pasurisë së paluajtshme", me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, objekt ekspertimi, nuk është i njëjti modular krahasuar me dokumentet modele krahasimi.

Pas kërkesës sonë si organ procedues, me vendimin me nr.481 datë 18/02/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive mbi pasurinë me nr.13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605.

Për nevoja të hetimit, është kërkuar informacion pranë ZVRPP Vlorë në lidhje me specialistin/jurist dhe hartograf të cilët kanë punuar në muajin Nëntor të vitit 2011, në zonën kadastrale me nr.8605, pranë ZVRPP Vlorë. Sipas përgjigjes së sjellë me nr.29611 Prot datë 29/06/2018 të dërguar nga ana e ZVRPP Vlorë, ky institucion ka kthyer përgjigje se nuk ka mundësi të percaktohet se kush jurist apo hartograf ka punuar ne periudhen Nentor 2011, ZK8605. Nga dokumentacioni i administruar nga

ZVRPP Vlore, me shkresen me nr.1064 Prot date 26/03/2018, është administruar dokumentacioni që lidhet me pasurinë që shtetasi Qirjako Gjikota ka blerë realisht dhe ka regjistruar më pas në ZVRPP Vlorë. Sipas këtij dokumentacioni, rezulton se me kontratën e shitblerjes së datës 22/03/1994, shtetasi Qirjako Gjikota ka blerë një objekt ish-kapanon, me sipërfaqe prej 320 m2, të ndodhur në territorin e ish-NB Serave, Vlorë dhe më tej këtë pasuri e ka regjistruar në ZVRPP Vlorë në regjistrin hipotekor me nr.192 datë 01/04/1994. Kjo pasuri mban numrin 57/36, zona kadastrale me nr.8605, Vlorë.

Më pas, në vitin 2004, shtetasi Qirjako Gjikota, ka lidhur kontratë shitje me nr.1128 Rep dhe nr.461 kol date 09/11/2004, me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit Dega Vlorë, përfaqësuar nga shtetasja Mjaftime Arapi, duke blerë edhe truallin poshtë ndërtesës prej 320m2 që kishte blerë dhe regjistruar më parë. Më pas në vitin 2004, ky shtetas ka aplikuar pranë ZVRPP Vlorë, duke regjistruar edhe truallin poshtë ndërtesës, pra me sipërfaqe prej 320m2.

Më pas, një pjesë të kësaj pasurie, konkretisht sipërfaqen prej 160m2, ky shtetas ja ka shitur me kontratën me nr.722 rep dhe nr.292 kol datë 09/03/2005, shtetasit Rahim Merkohitaj, kunatit të tij, kundrejt vlerës prej 1.950.000 lekë. Pra, e vetmja pasuri e ligjshme që ndodhet e pasqyruar në kartelat e pasurisë së paluajtshme në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, është ajo e cituar më sipër. I pyetur rreth fakteve të mësipërme, shtetasi Qirjako Gjikota, ka sqaruar se lidhur me pasurinë me sipërfaqe prej 2590m2, e regjistruar me nr.13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, ai nuk ka asnjë lloj dijenie në lidhje me procedurën e ndjekur për regjistrimin e kësaj pasurie, duke shpjeguar se nuk ka pasur ndonjëherë të regjistruar një sipërfaqe të tillë. Po kështu ky shtetas ka shpjeguar se nuk ka pasur dijeni më parë se në emër të tij ishte e regjistruar një pasuri e tillë.

Për nevoja të hetimeve, është sekuestruar e gjithë praktika e regjistrimit të pasurisë së mësipërmë dhe pas sekuestrimit të këtij dokumentacioni, është vendosur kryerja e ekspertimit teknik mbi dokumentat:

- Vërtetim pronësie Ipoteka Vlorë, me 01/04/1994, në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, me nr.00005905, ZK 8605, ne një fletë format ½ a4.

- Kontratë shitje, Nr.14610 Rep datë 22/03/1994, në një fletë format A4, e cila në fund të fletës, ana e djathtë ka numrin 00005905.

Sipas aktit të ekspertimit teknik me nr.6588 datë 02/07/2019, të dërguar nga ana e Institutit të Policisë Shkencore Tiranë, në lidhje me dy dokumentat e mësipërm ka rezultuar si më poshtë:

- Në dy dokumentat objekt ekspertimi, konstatohen ndërhyrje korigjuese, të cilat konsistojnë në mbulimin e përmbajtjes së shtypshkrimit të mëparshëm me një shtresë të hollë në ngjyrë të bardhë si ajo e korrektorit, përmbajtja e së cilës nuk mund të përcaktohet.
- Dy dokumentet objekt ekspertimi, janë shtypshkruar nga dy makina shkrimi të ndryshme.

Nga tërësia e akteve të administruara në interes të këtij procedimi penal, rezulton se në rastin konkret ndodhemi përpara elementëve të veprës penale të "Falsifikimi i dokumentave", parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Gjatë hetimit rezultoi e provuar se dokumenti "Kartela e pasurisë së paluajtshme" me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, është një dokument i falsifikuar. Për shkak se rubrikat e këtij dokumenti, rezultuan të ishin plotësuar me anën e skanerit dhe të printimit me printer me ngjyra, nuk u bë e mundur identifikimi i personit/personave që mund të kenë kryer falsifikimin e mësipërm. Në mungesë të të dhënave apo provave të tjera që do të mund të përcaktonin kohën e saktë të krijimit të këtij dokumenti, si dhe faktit që deri në vitin 2004 në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, rezultonte e regjistruar vetëm pasuria prej 320 m<sup>2</sup>, lidhur me kohën e tij vlen ti referohemi shënimeve që ndodhen në këtë dokument sipas të cilave data e pasqyrimit të faktit të regjistrimit të pasurisë që përmendet në dokument është 25/07/2006. Në këto kushte, referuar nenit 66, germa "ç" të Kodit Penal, ndodhemi përpara institutit të parashkrimit të ndjekjes penale.

Po kështu rezultuan me ndërhyrje dhe të falsifikuara edhe dy dokumentat e tjera dhe konkretisht dokumenti "Vërtetim pronësie Ipoteka Vlorë, me 01/04/1994, në

emër të shtetasit Qirjako Gjikota, me nr.00005905, ZK 8605, në një fletë format ½ a4; si dhe dokumenti Kontrate shitje, Nr.14610 Rep datë 22/03/1994, në një fletë format A4, e cila në fund të fletës, ana e djathtë ka numrin 00005905.

Nga dokumentacioni i sekuestruar pranë ZVRPP Vlorë, rezulton që në dokumentacionin e administruar nga ZVRPP fillimisht nga aplikuesi Qirjako Gjikota, sipërfaqja prej 2590m<sup>2</sup>, nuk ka qënë e cituar as në kontratën e shitjes me nr.14600 datë 22/03/1994 dhe as në vërtetimin e pronësisë datë 01/04/1994. E vetmja pasuri e regjistruar ligjërisht në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, ka qënë ajo me sipërfaqe prej 320m<sup>2</sup>, e ndodhur në territorin e ish-NB Serave, ish kapanoni me nr.9. Për sipërfaqen prej 2590m<sup>2</sup>, rezulton të jetë ndërhyrë në dokumentat e ekspertuara, duke shtuar të dhëna në lidhje me sipërfaqen prej 2590 m<sup>2</sup>. Edhe në këtë rast, është e pamundur të përcaktohet koha e saktë e ndërhyrjes në këto dy dokumenta si dhe personin që ka kryer këto veprime të kundraligjshme, duke ndërhyrë dhe falsifikuar përmbajtjen e këtyre dy dokumentave, por referuar faktit që shënimet në lidhje me sipërfaqen prej 2590m<sup>2</sup> në regjistrat e ZVRPP Vlorë mbajnë datën 25/07/2006, krijohet dyshimi i arsyeshëm se edhe keto ndërhyrje janë kryer ne këtë vit. Pra edhe në këtë rast, ndodhemi përpara parashkrimit të ndjekjes penale.

Ndërkohe lidhur me veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, nga aktet e administruara nuk rezulton që veprimet e falsifikimit dhe më tej të bashkangjites së dokumentit të falsifikuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të ZVRPP Vlorë, të jenë kryer nga punonjës të këtij institucioni. Në këto kushte, nga ana jonë si organ procedues vlerësohet se në rastin konkret, dyshimi në lidhje me konsumimin e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal nga punonjësit e ZVRPP Vlorë, nuk mbështetet në indiciet dhe të dhënat e përftuara në kuadër të këtij procedimi penal.Por edhe në rast se do të ishte provuar se veprimet e kundraligjshme të regjistrimit të pasurisë objekt hetimi do të ishin kryer nga punonjës të ZVRPP Vlorë, edhe në rastin konkret ndodhemi përpara institutit të parashkrimit të ndjekjes penale referuar faktit se shënimet në regjistrat e ZVRPP për pasurinë me sipërfaqe prej 2590m<sup>2</sup>, mbajnë datën 25/07/2006 .

Si rrjedhim kërkesa e prokurorit për pushimin e kësaj çështje penale është e mbështetur në fakte e në ligj.

Kjo kërkesë mbështet në nenin 329/a, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale shtuar me ligjin 35/2017, në të cilën parashikohet: "Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes."

Në nenin 328/1 të Kodit të Procedurës Penale është sanksionuar se: "Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilën ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë".

#### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, duke u mbështetur në nenin 329/a të Kodit të Procedurës Penale,

#### **VENDOSI:**

1. Të pushojë çështjen penale nr. 419/2018 të regjistruar për veprat penale "Falsifikim i dokumentave" dhe "Shpërdorim detyre", parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.
2. Pasuria e paluajtshme me nr. 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, ne emer te shtetasit Qirjako Lluka Gjikota", me sipërfaqe prej 2590m2, e vendosur nen masen e sigurimit pasuror "sekuestro preventive" me vendimin me nr.481 date 18/02/2019 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, te konfiskohet dhe te kaloj ne favor te shtetit.
3. Te deklarohet falsiteti i dokumentave te sekuestruara gjate hetimeve paraprake si: "Kartela e pasurise se paluajtshme" me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, ne emer te shtetasit Qirjako Lluka Gjikota"; Vertetim pronesie Ipoteka Vlore, me 01/04/1994, ne emer te shtetasit Qirjako Gjikota, me nr.00005905, ZK 8605, ne nje flete format 1/2 a4; Kontrate shitje, Nr.14610 Rep date 22/03/1994,

ne nje flete format A4, e cila ne fund te fletes, ana e djathte ka numrin 00005905, te cilat i jane bashkuar fashikullit te ketij procedimi penal duke urdheruar ndalimin e qarkullimit te tyre dhe vendosjen e shenjës treguese "dokument i falsifikuar".

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij.

Vlorë, më 27.01.2020


**SEKRETARE**

**BLERINA BRAHIMI**



**GJYQTARE**

**ARBANA SELMANAJ**



VENDIMI MORI FORMË TË PRERË  
PASI NUK U ANKIMUA  
ME DATË 09/03/2020  
VLORE, MË DATË 10/03/2020  
KRYESEKRETARE  
Esmeralda Ngucaj

